



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, Trupi Gjyqësor, më 18 korrik, rrëzoi një kërkesë të Prokurorisë për apelimin e një vendimi të mëparshëm të Trupit Gjyqësor për përjashtimin e një prove të caktuar lidhur me një dëshmitar. Trupi Gjyqësor e përjashtoi këtë provë pasi konstatoi se kishte vlerë provuese të kufizuar dhe në thelb mund të ishte cenuese për z. Selimi.

Në të njëjtën çështje, Trupi Gjyqësor më 10 korrik lëshoi një vendim me të cilin lejoi dy viktimat të tjera të merrnin pjesë në procesin gjyqësor. Ata do t'i bashkohen grupit ekzistues prej 152 viktimash dhe do të përfaqësohen nga i njëjti Mbrojtës Viktimash. Trupi Gjyqësor theksoi në këtë vendim se afati për dorëzimin e kërkesës për të marrë pjesë si viktimë në këtë çështje gjyqësore kishte përfunduar më 15 shkurt 2023. Sidoqoftë, Trupi Gjyqësor konstatoi se kishte arsye të vlefshme dhe i pranoi kërkesat, ndonëse ato u dorëzuan pas afatit. Kjo e çoi numrin e viktimave pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore në 154 gjithsej.

Më 22 korrik, Trupi Gjyqësor miratoi, pjesërisht, kërkesën e Prokurorisë për pranimin e deklaratave me shkrim dhe provave materiale shoqëruese të tetë dëshmitarëve në provat gjyqësore. Gjegjësisht, Trupi Gjyqësor miratoi kërkesën e Prokurorisë lidhur me gjashtë dëshmitarë. Për dy dëshmitarët e tjerë, Trupi Gjyqësor vendosi se, krahas dorëzimit të deklaratave të tyre me shkrim, ata duhet të paraqiten edhe në gjykim. Trupi Gjyqësor konstatoi se disa prej informacioneve në deklaratat e këtyre dëshmitarëve nuk janë dhënë nga asnjë dëshmitar tjetër dhe në një prej deklaratave ka mospërputhje. Rrjedhimisht, Trupi Gjyqësor vlerësoi se është e rëndësishme për Mbrojtjen të ketë mundësi t'u bëjë pyetje këtyre dy dëshmitarëve.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për datën 19 gusht, në orën 9 të mëngjesit.

Në çështjen *Pjetër Shala*, Kryetare Trendafilova, më 22 korrik caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me një kërkesë të Mbrojtjes së Shalës për të zgatur afatin për dorëzimin e njoftimit për apel. Paneli i Apelit përbëhet nga gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

Më 24 korrik, Paneli i Apelit vendosi se gjuha e punës në procedurën e apelit në këtë çështje gjyqësore do të jetë anglishtja dhe lëshoi një vendim lidhur me modalitetet e pjesëmarrjes së viktimave. Në bazë të këtij vendimi, Mbrojtësi i Viktimave do të vijojë të ketë qasje në dosjen e plotë të çështjes, do të njoftohet lidhur me të gjitha materialet provuese të nxjerra dhe të shpërndara, mund të vazhdojë të bëjë parashtrime me shkrim për sa kohë që ato lidhen me interesat e viktimave pjesëmarrëse si dhe do të vazhdojë të informojë viktimat për procesin.





Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, më 22 korrik u publikua versioni i redaktuar publik i vendimit të Gjykatësit të Vetëm i 25 marsit lidhur me Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Caktimin e Datës për Pagimin e Zhdëmtimeve dhe Çështje të Tjera.

Në këtë vendim, Gjykatësi i Vetëm u pajtua me Mbrojtësen e Viktimave se Urdhri për Zhdëmtim mund të zbatohet menjëherë duke qenë se z. Mustafa nuk e apeloj dhe se ka vendim të formës së prerë në këtë çështje gjyqësore.

Gjykatësi i Vetëm ftoi z. Mustafa të bënte pagesa vullnetarisht dhe urdhëroi Administratoren ta informonte atë për modalitetet përkatëse. Ai, gjithashtu lëshoi urdhra lidhur me pasuritë e mundshme të z. Mustafa që mund të përdoren për zbatimin e pjesshëm të Urdhrit për Zhdëmtim mbi bazën e pagesave proporcionale të viktimave. Gjykatësi i Vetëm udhëzoi Administratoren që, sapo të merreshin fondet, të konsultohet me Mbrojtësen e Viktimave për mënyrën më efektive për dorëzimin e fondeve të akorduara për secilën viktimitë.

Gjykatësi i Vetëm rikujtoi më tej se, pavarësisht zbatimit të pjesshëm të Urdhrit për Zhdëmtim, z. Mustafa nuk lirohet nga detyrimi për të shlyer plotësisht zhdëmtimin, pavarësisht se aktualisht nuk është në gjendje ta bëjë këtë. Për të siguruar pajtueshmëri të plotë me Urdhrin, Gjykatësi i Vetëm udhëzoi Administratoren të vlerësonte mjetet aktuale dhe të ardhshme të z. Mustafa, duke mbajtur parasysh edhe nevojat e familjes së tij.

Gjykatësi i Vetëm gjithashtu theksoi se para dorëzimit të kërkesave të mundshme në programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit në Kosovë, duhet përcaktuar nëse, dhe deri në ç'masë, mund ta shlyejë vetë z. Mustafa Urdhrin për Zhdëmtim brenda një afati të arsyeshëm.

Gjykatësi i Vetëm theksoi se nuk ka afat për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim dhe se detyrimi i z. Mustafa lidhur me viktimat përfundon vetëm kur të jetë zbatuar plotësisht Urdhri për Zhdëmtim.

Në çështjen gjyqësore *Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala*, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, më 23 korrik lëshoi një vendim lidhur me kërkesa të ndryshme të ekipeve të Mbrojtjes. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes së Shalës për mbajtjen e një konference mbi ecurinë e çështjes, pasi konstatoi se pikat e ngritura, si problemet me qasjen në *Legal Workflow* dhe financimi i ekipeve të Mbrojtjes, ishin zgjidhur tashmë. Ajo i rikujtoi Mbrojtjes së Shalës se aspektet lidhur me *Legal Workflow* dhe ndihmën juridike duhet t'ia paraqesë Zyrës Administrative në të ardhmen, përpara se t'i drejtohet Trupit Gjykues, në mënyrë që problemet të zgjidhen shpejt dhe në mënyrë efektive.

Mbrojtja e Januzit kishte kërkuar zgjatje afati për dorëzimin e dosjes paraprake. Bazuar në faktin se Mbrojtja e Bahtijarit dhe e Januzit kanë dorëzuar mocione paraprake ku pretendojnë se ka gabime në Aktakuzën e Ndryshuar, atëherë Gjykatësja e Procedurës Paraprake i zgjati afatet si më poshtë:





Në rast se Mbrojtja nuk apelon vendimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake lidhur me mocionet paraprake të Mbrojtjes, dosjet përkatëse do të dorëzohen pesë ditë pasi të lëshojë vendim Gjykatësja e Procedurës Paraprake lidhur me mocionet në fjalë. Në rast se e apelojnë vendimin e saj, atëherë afati do të jetë pesë ditë pasi të lëshojë vendim Paneli i Gjykatës së Apelit.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake vendosi se data e re për kalimin e dosjes së çështjes te Trupi Gjykues do të jetë dy ditë pas dorëzimit të dosjeve paraprake të Mbrojtjes, nëse do të dorëzojnë të tilla, ose në përfundim të afatit përkues.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi Administratoren të riklasifikojë parashtrimet përkatëse lidhur me aspektet e diskutuara si publike, me përjashtim të shtojcës konfidenciale.

Ndër lajme të tjera: pushimet e gjykatës së Dhomave të Specializuara fillojnë të hënën, më 29 korrik dhe do të zgjasin deri të premtën, 16 gusht 2024. Gjatë kësaj periudhe nuk do të ketë seanca gjyqësore dhe disa prej shërbimeve jothelbësore do të reduktohen në minimum. Sidoqoftë, Gjykata do të jetë tërësisht funksionale dhe puna do të vijojë në të gjitha njësitë e Dhomave të Specializuara.

Gjatë pushimit mund të dorëzohen parashtrime dhe, përveç nëse urdhërohet ndryshe nga gjykatësit, afatet gjyqësore mbeten të pandryshueshme.

Nuk do të ketë informim javor për mediat gjatë pushimeve të gjykatës, kështu që informimi javor i ardhshëm do të jetë të enjten, më 22 gusht 2024, në orën 14:30.

